



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

V E N D I M

Nr. 171, datë 18/11/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 31, datë 04.05.2020, e E.Z. ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”¹, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi është emëruar specialist mjedisi pranë Bashkisë Mallakastër në janar të vitit 2016. Fillimisht marrëdhënia e punës është rregulluar nëpërmjet disa kontratave individuale pune me afat të caktuar. Në vijim, brenda vitit 2016, ai ka konkuruar në Bashkinë Mallakastër për t’u pranuar në shërbimin civil, në pozicionin Specialist (inxhinier mjedisi), Sektori i Pyjeve dhe i Mjedisit, ku dhe është shpallur fitues.

¹ Referuar vërtetimit nr. 1, datë 02.02.2020, të lëshuar nga PD, Dega Mallakastër rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i këtij subjekti politik.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 63, datë 31.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, “*Për lëvizjen e personelit brenda institucionit të Bashkisë Mallakastër*”, E. Z. është emëruar në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër.

Si rezultat i zgjedhjeve të zhvilluara në 30 Qershor 2019, Bashkia Mallakastër pati ndryshim të titullarit të institucionit. Nga momenti i ardhjes në detyrë të Kryetarit të ri, të Bashkisë Mallakastër, i cili është përfaqësues i Partisë Socialiste, E.Z. pretendon se ndaj tij ka filluar diskriminimi për shkak të bindjeve politike të tij, të djathta. Ankuesi pretendon se Zv/Kryetari i Bashkisë Mallakastër i ka vënë në dukje bindjet e tij politike, që janë të ndryshme nga bindjet e tij dhe të Kryetarit të Bashkisë, si dhe është shprehur se ai nuk mund ta “mbante akoma” në punë. E.Z. pretendon se i është kërkuar, që të takojë Kryetarin e Bashkisë Mallakastër dhe të bëjë mbështetës i tij, gjë të cilën ankuesi nuk kishte pranuar ta bënte.

Ankuesi pretendon se në fillim të muajit Janar 2020, pasi është njoftuar zyrtarisht për takim në Zyrën e Burimeve Njerëzore, është njoftuar verbalisht nga Përgjegjësia e Sektorit të Burimeve Njerëzore, për ekzistencën e një Vendimi të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), sipas së cilit rezultonte se nga kontrolli, që ishte ushtruar nga KMSHC-ja në institucionin e Bashkisë Mallakastër, ishte konstatuar se akti i emërimit të tij në pozicionin e *Përgjegjës të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit* është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Përgjegjësia e Sektorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër i ka komunikuar ankuesit se nga KMSHC janë konstatuar 11 akte emërimi absolutisht të pavlefshëm pranë këtij institucioni. Ankuesi i ka kërkuar Përgjegjësën së Sektorit të Burimeve Njerëzore që t’i vërë në dispozicion vendimin e sipërpërmendur, me qëllim njohjen me përmbajtjen e tij dhe për të verifikuar faktin, nëse emri i tij bënte pjesë në atë vendim, por ky akt nuk i është vënë në dispozicion.

Në një takim, ankuesi pretendon se Kryetari i Bashkisë i ka komunikuar se në atë vendim thuhej se akti i emërimit të E.Z., në pozicionin aktual të punës ishte konstatuar si akt absolutisht i pavlefshëm dhe që marrëdhënia e punës duhej të ndërpritej, me qëllim që të rregullohej paligjshmëria e bërë nga kryetari i mëparshëm, si dhe nga administrata e kaluar. Ankuesi pretendon se Kryetari i Bashkisë është shprehur se të 11-të punonjësit e përmendur në vendimin e KMSHC-së, aktet e emërimit të të cilëve ishin shpallur të pavlefshme, do largoheshin nga detyra dhe këto pozicione pune do të shpallehin e do të plotësoheshin sipas dispozitave ligjore në fuqi për Shërbimin Civil.

Ankuesi pretendon se e ka bërë me dije Kryetarin e Bashkisë, se në datën 31.01.2018 është transferuar në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Mjedisit dhe Pyjeve duke u larguar nga detyra e Specialistit të Mjedisit, ku ishte nëpunës civil, i konfirmuar, në kategorinë: *Specialist (Inxhinier mjedisi), Sektori i Pyjeve dhe i Mjedisit*, status që ishte ende i vlefshëm. Në këtë kontekst, ai i ka kërkuar Kryetarin të Bashkisë që ta kthejë në këtë pozicion pune. Kryetari është shprehur se ky pozicion pune ishte mbyllur dhe në strukturën e re të Bashkisë Mallakastër nuk kishte vend pune për të.

Ankuesi pretendon se pas përfundimit të bisedës rreth Vendimit të KMSHC-së, Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka kaluar në një bisedë personale, që nuk lidhej me detyrën e ankuesit. Kjo bisedë kishte përmbajtje politike dhe u fokusua tek bindjet e tij, të djathta. Tema kryesore në këtë bisedë ishin bindjet politike të E. Z., mbështetja e tij për ish -Kryetarin e Bashkisë, A. K., si dhe refuzimi i zgjedhjeve të 30 Qershor 2019 nga ana e tij, duke mos marrë pjesë në votim.

Nëpërmjet shërbimit postar, ankuesi ka marrë në dorëzim shkresën nr. 263 regj., datë 23.01.2020 e Kryetarit të Bashkisë Mallkastër z. Q. I., *“Njoftim për zhvillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës”*. Me anë të kësaj shkrese, ankuesi është njoftuar se në datën 27.01.2020, ora 10.00, në zyrën e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të zhvillohej takim midis tij dhe personit të autorizuar nga punëdhënësi. Qëllimi i takimit ishte për të parashtruar arsyet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Në takim, ankuesit i është komunikuar nga Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore, se arsyet që kanë çuar në marrjen e vendimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ishin mbështetur në vendimin e Komisionerit të Shërbimit Civil, sipas së cilit akti i emërimit të tij është absolutisht i pa vlefshëm. Ankuesi sqaron se ka refuzuar ta nënshkruajë procesverbalin e takimit, me arsyetimin se nuk i është dhënë Vendimi i KMSHC-së, për të konstatuar nëse ishte emri i tij në atë vendim apo jo.

Në vijim, në fillim të muajit shkurt, nëpërmjet Urdhërit nr. 113, datë 03.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare të E. Z.”*, ankuesi lirohet nga detyra. Motivacioni mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është mbështetur tek Vendimi nr. 112, datë 05.11.2019, i Komisionerit të Shërbimit Civil, ku është konstatuar se akti i emërimit të ankuesit është absolutisht i pavlefshëm.

E. Z. thekson faktin se është vënë në dijeni mbi përmbajtjen e aktit të mësipërm nga institucioni i KMSHC-së, pas korrespondencës zyrtare të patur më të. Në këtë vendim, përcaktohet shprehimisht, që ky akt duhej bërë transparent për të gjithë punonjësit e përfshirë në të, gjë që nuk është bërë asnjëherë nga titullari i Bashkisë Mallakastër.

Për sa më sipër, ankuesi shprehet se ai është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike të djathta.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 31, datë 04.05.2020, e E.Z., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua subjekteve përkatëse me shkresën nr. 552/1, datë 20.05.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 2. Aktet e emërimit të tij në të gjitha pozicionet e punës pranë Bashkisë Mallakastër;
 3. Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ku të përfshihen akti i njoftimit, procesverbali i takimit dhe urdhëri i lirimimit nga detyra;
 4. Vendimi nr. 112, datë 05.11.2019, i Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil;
 5. Urdhërat e lirimimit nga detyra të 11 punonjësve të Bashkisë Mallakastër, aktet e emërimit të së cilëve u konstatuan si absolutisht të pavlefshëm nga KMSHC;
 6. Struktura organike aktuale dhe ajo e mëparëshme e Bashkisë Mallakastër.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

7. Informacion nëse pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Mjedisit dhe Pyjeve, pranë Bashkisë Mallakastër është shpallur vakant dhe nëse ankuesi ka konkuruar për këtë pozicion pune, sipas dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil.
 8. Informacion, nëse ankuesi ka depozituar kërkesë me shkrim (para lirimit nga detyra) pranë Bashkisë Mallakastër, për t'u sistemuar në një pozicion për specialist, në përputhje me arsimin e tij.
 9. Informacion nëse ankuesit i është dhënë zyrtarisht kopje e vendimit nr. 112, datë 05.11.2019 të KMSHC-së. Të përcillet pranë Komisionerit, kopje e shkresës përkatëse.
- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Bashkia Mallakastër dërgoi shkresën nr. 1277, datë 12.06.2020, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se ankuesi E. Z. ka filluar punë në Bashkinë Mallakastër, në datën 07.01.2016, në pozicionin e punës specialist mjedisi.

Në vijim, në vitin 2016, në Bashkinë Mallakastër është shpallur procedura për lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë sistemit të shërbimit civil për pozicionin specialist (inxhinier mjedisi) dhe E.Z. është kualifikuar për pranim nga jashtë shërbimit civil dhe është shpallur fitues. Me aktin nr. 1492, datë 08.08.2016, ai është emëruar nëpunës civil në periudhë prove.

Pas trajnimeve të detyrueshme, të kryera nga ASPA, ku është vlerësuar me rezultatin 16 pikë nga 26 pikë të mundshme, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nxjerr aktin e emërimit nr. 1468, datë 08.08.2017, për konfirmim të statutit. Në janar të vitit 2018, E.Z. emërohet në pozicionin “përgjegjës i pyjeve dhe mjedisit” në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr. 63, datë 31.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër. E. Z. rezulton se e ka firmosur kontratën e punës me vullnet të lirë dhe të plotë duke e ditur që statusi i nëpunësit civil do të humbte vlerën juridike. Si rrjedhojë, ish-punonjësi ka hequr dorë nga statusi me vullnetin e tij që në pranimin e pozicionit me urdhër të brendshëm pune, ku parashikohet se: *“Nëpunësit civil të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë të konkurojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”*. Për sa më sipër, rezulton se E.Z. nuk ka konkuruar për asnjë nga këto procedura dhe vlefshmëria e statusit ka qenë në fuqi deri në datën 31.01.2020⁴. Edhe pse është shpallur vakant pozicioni “Përgjegjës i pyjeve dhe mjedisit”, ai nuk ka konkuruar për faktin se nuk ka kualifikimin profesional, që është ndër kriteret bazë për të përfituar statusin e përgjegjësit. Në vijim, marrëdhënia e punës ka vazhduar në kundërshtim me ligjin e nëpunësit civil.

⁴ Në zbatim të nenit 64, pika 4 ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar);

Në datën 13.08.2019, Q. I. ka marrë drejtimin e Bashkisë Mallakastër. Nga kjo datë e në vijim, Kryetari i Bashkisë Mallakastër nuk ka patur asnjë tendencë apo qëllim për të ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesin, deri në momentin që në adresë të këtij institucioni është dërguar Vendimi nr. 112, datë 11.11.2019, i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC). Në këtë vendim janë evidentuar raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), ku pjesë përbërëse e këtij vendimi ishte edhe rasti i punonjësit E.Z.. Me qëllim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, nëpërmjet këtij vendimi, KMSHC ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të konstatoje si akte absolutisht të pavlefshme, 11 aktet e emërimit të punonjësve, përfshirë këtu edhe aktin e emërimit të E. Z. Në këtë kontekst është kërkuar që Njësia Përgjegjëse⁵ të shpallë menjëherë pozicionet e punës të lira, në kuptim të ligjit, dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e procedurave të konkurrimit, në përputhje me nevojat e institucionit. Në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër janë marrë masa konkrete për zbatimin e Vendimit nr. 112, datë 11.11.2019, të KMSHC-së lidhur me vendosjen e ligjshmërisë për të gjithë punonjësit⁶, që nuk plotësojnë kriteret ligjore për pozicionin e punës përkatës. Në janar 2020, institucioni i Bashkisë Mallakastër iu nënshtroi ristrukturimit organizativ, duke pësuar ndryshime në sektorë dhe drejtori të ndryshme dhe për këtë arsye ishte e domosdoshme që të pritej miratimi i planit vjetor “Për pranim në shërbimin civil” për vitin 2020 dhe më tej të vijojej me shpallje të procedurave. Miratimi i planit vjetor “Për pranim në shërbimin civil” është bërë në datën 28.02.2020. Nisur nga krijimi i situatës së pandemisë botërore COVID-19, procedurat e shpalljeve janë pezulluar deri në përfundim të situatës së krijuar. Në shkresën e Bashkisë Mallakastër theksohet fakti se për të gjithë punonjësit e tjerë të atakuar në vendimin e KMSHC-së, në vijimësi do të vendoset situata e ligjshmërisë. Vendimi nr. 112, datë 05.11.2019, i KMSHC-së i është dërguar zyrtarisht Bashkisë Mallakastër dhe nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është njoftuar çdo punonjës, që ka qenë i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe është i evidentuar në këtë vendim, përfshirë këtu ankuesin.

Për ankuesin E. Z. ka filluar procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës duke mos patur asnjë tendencë negative, por punonjësit i është dhënë mundësia për t’u shprehur dhe i është propozuar që në procesverbalin e takimit paraprak të shkruante dhe të kërkonte, për t’u emëruar si specialist në po të njëjtin sektor, por ai nuk ka pranuar me pretendimin se kishte ulje page dhe nuk mund të kalonte nga përgjegjës sektori në specialist. Për sa i përket pretendimit të ankuesit se ai ka biseduar me Kryetarin dhe Zv/Kryetarin e Bashkisë për bindjet e tij të djathta, këto janë të pafaktuara dhe të pabazuara, por thjesht aludime dashakeqëse të E. Z.

⁵ Referuar shkresës nr. 1277, datë 12.06.2020, së Bashkisë Mallakastër;

⁶ Referuar shkresës nr. 1277, datë 12.06.2020 së Bashkisë Mallakastër;

Në shkresën e Bashkisë Mallakastër theksohet fakti se nëse do të kishte disfavorizim sikurse pretendon ankuesi, zgjidhja e kontratës së punës do të bëhej në mënyrë të menjëherëshme, por nga Sektori i Burimeve Njerëzore janë marrë masat për zbatim të procedurave ligjore duke respektuar afatin e njoftimit 2 mujor sipas Kodit të Punës. Nga ana e institucionit nuk është bërë dhe nuk bëhet asnjë investigim për anëtarësimet në ndonjë parti politike të punonjësve. Për çdo punonjës vlerësohet dosja personale (kualifikimi profesional) i dokumentuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Pozicionet e lira të punës nuk plotësohen me burime njerëzore jo profesionale sipas pretendimeve të ankuesit, por duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil. Për këtë arsye, pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Mjedisit dhe Pyjeve në Bashkinë Mallakastër është ende vakant, ç'ka ka sjellë në vëmendje të Komisionerit se institucioni i Bashkisë Mallakastër do të ndjekë procedurat ligjore për rekrutimin e nëpunësve civilë dhe palës ankueses i lind e drejta për të konkurruar për pranim nga jashtë për këtë pozicion pune dhe të kualifikohet nëse plotëson kriteret sipas ligjit.

Bashkëlidhur shkresës nr.1277, datë 12.06.2020, Bashkia Mallakastër ka dërguar bashkëlidhur aktet e emërimit të E. Z. në të gjitha pozicionet e punës pranë Bashkisë Mallakastër, praktikën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, Vendimin nr. 112, datë 05.11.2019, strukturën organike aktuale dhe atë të mëparshme të Bashkisë Mallakastër.

Për sa i përket vendosjes së ligjshmërisë për 11 punonjësit e sipërpërmendur, Bashkia Mallakastër informon se shpjegimet përkatëse gjenden në shkresën nr. 1080/1, datë 27.05.2020, dërguar Komisionerit për Mbikqyrjen në Shërbimin Civil, e-mailin zyrtar dërguar z. S.Ll., si dhe shkresën nr. 477/1, datë 14.02.2020 dërguar Prefektit të Qarkut.

Për sa i përket informacionit nëse pozicioni i përgjegjësit është shpallur vakant dhe nëse ankuesi ka konkurruar për këtë pozicion pune, në shkresën e Bashkisë Mallakastër theksohet fakti se kjo procedurë është e dokumentuar, është bërë shpallja në tetor të vitit 2018 dhe E.Z. nuk ka konkurruar për arsye të mospërbushjes së kriterëve kualifikuese.

Për sa i përket informacionit nëse ankuesi ka depozituar kërkesë me shkrim (para lirit nga detyra) për t'u sistemuar në një pozicion pune për specialisit, nuk rezulton të ketë kërkesë me shkrim, të ankuesit, që të jetë dokumentuar pranë Bashkisë Mallakastër. Në procesverbalin e takimit, nga Njësia e Burimeve Njerëzore i është sugjeruar të bëhej kjo kërkesë dhe ai nuk ka pranuar, me pretendimin se ka ulje në pagë.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit se nuk i është dhënë kopje e Vendimit nr. 112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së, theksohet fakti se punonjësit i është komunikuar fakti që emri i tij bën pjesë në këtë vendim, sikurse edhe të gjithë punonjësve të tjerë, i është sqaruar përmbajtja e vendimit dhe se ky vendim është i publikuar në faqen zyrtare të KMSHC-së. Çdo individ mund të njihet me përmbajtjen e vendimit pa asnjë pengesë. Për këtë fakt, pretendimi i ankuesit është absolutisht i pabazuar.

- Ankuesi dërgoi shkresën nr. 552/4, datë 05.08.2020, si dhe e-maile vijuese, ku sërisht shpreh pretendimet e tij, lidhur me largimin nga puna dhe mos sistemimin e tij, në një pozicion tjetër pune brenda Bashkisë Mallakastër.

Për sa më sipër, ankuesi thekson faktin se Vendimi nr. 112/2019, i KMSHC-së nuk shprehet që 11 punonjësit e Bashkisë Mallakastër, aktet e emërimit të së cilëve, janë gjetur të paligjshëm, të largohen nga institucioni. Ai sqaron se Bashkia Mallakastër e ka zbatuar vendimin e sipërcituar të KMSHC-së me dy standarde, pasi nga 4 punonjës që janë larguar nga puna, njëri është rikthyer në punë, ndërkohë që edhe 7 punonjësit të tjerë kanë vazhduar të punojnë në pozicionet e tyre të punës, pavarësisht se aktet e emërimit të tyre janë gjetur të paligjshëm. Këta punonjës kanë punuar në pozicionet respektive të punës, deri në momentin që këto pozicione janë shpallur për konkurim nga ana e këtij institucioni. E.Z. shprehet se znj. L.S. dhe znj. M.Sh. që janë dy punonjëse të Bashkisë Mallakastër, që janë përfshirë në Vendimin nr. 112/2019 të KMSHC-së, vazhdojnë ende të punojnë në pozicionet e tyre të punës.

Njëkohësisht, ankuesi vë në dukje faktin se mosdhënia e një kopje të Vendimit nr. 112/2019, të KMSHC-së është veprim i padrejtë i ndërmarrë ndaj punonjësve të përfshirë në të, për sa kohë që në këtë vendim citohej shprehimisht që punonjësit e prekur duhet të njoftoheshin. Kryetari i Bashkisë Mallakastër nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion që E.Z. ka depozituar pranë këtij institucioni, nëpërmjet së cilës kërkon të disponojë një kopje të vendimit të mësipërm. Mungesa e transparencës së Bashkisë Mallakastër, lidhur me sa më sipër, konsiderohet e paligjshme dhe diskriminuese nga ana e ankuesit. Ankuesi e bën me dije KMD-në se së fundmi, ka depozituar padi pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Fier, kundër Bashkisë Mallakastër, me objekt: detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin për vjetërsi në punë sa paga e një 15 ditëshi në vit, si dhe detyrimin e palës së paditur për të paguar në formën e shpërblimit lejen vjetore të pakryer për vitin 2019 dhe për vitin 2020, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 10.04.2020.

Njëkohësisht, nëpërmjet e-maileve të dërguara në adresë të Komisionerit, ankuesi ka vënë në dispozicion në cilësi prove aktet *“Deklaratë e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe*

të larguarve nga puna nr. 286, datë 11.09.2020”, shkresën nr. 1665/1, datë 19.08.2020, e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me lëndë “Njoftim i listës përfundimtare të rezultatit për verifikimet paraprake për procedurën e pranimit nga jashtë sistemit të shërbimit civil për nëpunësin civil” dhe shkresën nr. 1665/2, datë 14.09.2020, e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me lëndë “Njoftim i listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve për procedurën e pranimit nga jashtë sistemit të shërbimit civil për nëpunësit civilë”.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore për shqyrtimin e ankesës së E. Z., Komisioneri vendosi të zhvillojë një seancë dëgjimore, në datën 04.08.2020. Palët u njoftuan për këtë seancë dëgjimore, nëpërmjet shkresës nr. 552/2, datë 07.07.2020, së KMD-së.

Në vijim, palët u njoftuan për anulim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës nr. 552/4, datë 27.07.2020, së KMD-së si pasojë e situatës së krijuar nga Pandemia e Covid-19.

D. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

E. Z. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Në strukturën e Bashkisë Mallakastër, të miratuar me Vendimin nr. 91, datë 20.12.2018 “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe institucioneve në vartësi, strukturës organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Mallakastër për vitin 2019*”, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori, 1 Specialist (inxhinier mjedisi) , 1 specialist të zonave të mbrojtuar, 3 inspektorë pyjesh dhe 20 vrojtues pyjesh. Z. E.Z. është punësuar pranë Bashkisë Mallakastër nëpërmjet Urdhërit nr. 05, datë 15.01.2015, të Kryetarit të kësaj Bashkie, në pozicionin e punës specialist inxhinier mjedisi, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Pyjeve, Mjedisit dhe Tokës Bujqësore. Në vijim, në vitin 2016, në Bashkinë Mallakastër është shpallur procedura për lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë sistemit të shërbimit civil për pozicionin specialist (inxhinier mjedisi) dhe E. Z. është kualifikuar për pranim nga jashtë shërbimit civil, është shpallur fitues, si dhe është emëruar nëpunës civil në periudhë prove. Nëpërmjet shkresës nr. 1468, datë 08.09.2017, të Njësisë së Menaxhimit të Burimeve

Njerëzore, ankuesi E. Z. është emëruar nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin Specialist (inxhinier mjedisi), Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, Drejtoria e Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër.

Pretendimi për diskriminim i ankuesit konsiston në 3 momente, ku i pari ka të bëjë me largimin e tij nga detyra, momenti i dytë konsiston në mos dhënien e vendimit nr. 112/2019 të KSHC-së nga ana e Bashkisë Mallakastër dhe momenti i tretë konsiston në mos sistemimin e tij në një pozicion tjetër pranë Bashkisë Mallakastër.

Lidhur me momentin e parë, Komisioneri ka konstatuar se nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 63, datë 31.01.2018 “Për lëvizjen e personelit brenda institucionit të Bashkisë Mallakastër” E. Z. ka kaluar nga pozicioni i specialistit, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit. Në vijim të këtij Urdhëri, marrëdhënia ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe E. Z. është rregulluar nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës së lidhur ndërmjet palëve. Për sa më sipër, në kushtet e moszbatimit të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), për ngritjen në detyrë, E. Z. rezulton se ka hequr dorë nga statusi i nëpunësit civil, në nivel specialisti dhe është emëruar në bazë të aktit të sipërpërmendur të Titullarit të Bashkisë Mallakastër, në një pozicion hierarkik me të lartë, atë të përgjegjës të sektorit.

Në vitin 2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), mbështetur në Urdhërin nr. 65, datë 12.09.2019, të KMSHC, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësit civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Mallakastër. Kryeja e këtij procesi përkoi përgjatë së njëjtës periudhë kohore, në të cilën erdhi në detyrë Kryetari i ri, i Bashkisë Mallakastër, Q. I., i cili rezultoi fitues nga zgjedhjet vendore të kryera në muajin qershor 2019.

Në përfundim të verifikimeve të kryera, KMSHC është shprehur me Vendimin nr. 112, datë 05.11.2019, në të cilin citohet: “Sipas strukturës aktuale, Bashkia Mallakastër së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithësej 66 pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: 1 pozicion i nivelit të lartë drejtues, 6 pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, 18 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe 41 pozicione të kategorisë ekzekutive.....Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se 43 pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; 11 pozicione të shërbimit civil rezultojnë të plotësuara me punonjës të punësuar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme dhe jo sipas një procedure konkurimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës së kategorisë ekzekutive, ose nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues,”..

Në vijim, Vendimi i KMSHC përmend konkretisht rastet e 11 emërimeve në kundërshtim me ligjin, ku specifikon pozicionin e punës, punonjësin që kryen aktualisht detyrën, si dhe aktin e emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit. Për sa më sipër, në vendim citohet: “4. Z. E.Z., Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, emëruar me urdhërin e brendshëm nr. 63, datë 31.01.2018.”

KMSHC ka evidentuar se aktet e mësipërme të emërimit kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht, kërkesat e një procedurë të rregullt konkurimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pika i) dhe ii) të shkronjave a) dhe c), të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” është i pavlefshëm. Në vijim të këtij arsyetimi, në vendim theksohet fakti se, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, veprimi administrativ i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Në pikën 1, të dispozitivit të këtij Vendimi është vendosur shprehimisht: “1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkojë nga kryetari i Bashkisë Mallakastër, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshme, 11 aktet e emërimit të punonjësve të mëposhtëm:.....z. E.Z., Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, emëruar me urdhërin e brendshëm nr. 63, datë 31.01.2018.”

Në vijim, në pikën 2 të dispozitivit të vendimit është kërkuar që njësia përgjegjëse të shpallë menjëherë pozicionet e mësipërme, të lira në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e procedurave të konkurrimit, në përputhje me nevojat që do të ketë institucioni. Njëkohësisht në pikën 3 të tij, kërkohet nga Bashkia Mallakastër që të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm për pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 25.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Sipas vendimit të mësipërm, KMSHC⁷ ka përcaktuar se në rast moszbatimi të këtij vendimi, ky institucion do të përdorë të gjithë mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e Vendimit nr. 112, datë 05.11.2019.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar, Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë masat përkatëse për vendosjen e ligjshmërisë në administrimin civil. Për rastin konkret, ka filluar procedurën për largimin nga puna të z. E.Z.dhe të disa punonjësve të tjerë të cituar në vendimin e KMSHC-së. Nëpërmjet shkresës nr. 263, datë 23.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, me lëndë *“Njoftim për zhvillimin e takimit për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës”*, ankuesi E.Z. është njoftuar se në datën 27.01.2020, pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër, për të diskutuar marrëdhëniet e punës me këtë institucion. Në këtë shkresë citohet shprehimisht: *“Ky takim realizohet me qëllim për t’u parashtruar arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe për t’u dhënë juve mundësinë për t’u shprehur”*. Takimi i sipërpërmendur është realizuar në datën e sipërpërmendur, ku ankuesit i është komunikuar se shkaqet që kanë çuar në marrje e këtij vendimi janë konstatimet dhe urdhëresat e Vendimit nr.112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së. Në vijim, është miratuar Urdhëri nr. 113, datë 03.02.2020, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare të z. E.Z.”*, ku në pikën 1 të tij, përcaktohet: *“Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare për shkak se: Bazuar në vendimin paralajmëruar nr. 112, datë 05.11.2019, të Komisionerit të Shërbimit Civil konstatohet se akti i emërimit të pozicionit tuaj është absolutisht i pavlefshëm.”* Sipas këtij vendimi marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me ankuesin ndërpritën në datën 03.04.2020, por për efekt të paraqitjes së raportit 5 ditor për paaftësi të përkohshme nga ana e ankuesit, data e sipërpërmendur është shtyrë për në datën 10.04.2020.⁸

Përveç E. Z., në zbatim të Vendimit nr.112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së janë larguar nga puna edhe E.H., E.B., E. Z. dhe A.A⁹. Referuar shkresës nr. 1080, datë 27.05.2020, të Bashkisë Mallakastër drejtuar KMSHC-së rezulton se në fillim të muajit janar 2020 ka hyrë në fuqi struktura organizative, e cila do të funksionojë për vitin kalendarik 2020 dhe se Bashkia Mallakastër ka kaluar në proces ristrukturimi e organizimi të brendshëm. Nisur nga ky fakt, në përshtatje me strukturën organizative janë ndërmarrë veprimet përkatëse për disa nga punonjësit e përmendur në

⁷ Referuar pikës 7 të dispozitivit të Vendimit nr.112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së;

⁸ Nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 113/1, datë 08.04.2020 *“Për zgjatjen e afatit të marrëdhënies së punës së Z. E.Z.”*.

⁹ Z. A.A. ka konkuruar në muajin korrik 2020 pranë Bashkisë Mallakastër dhe ka rezultuar fitues në pozicionin specialisit i Sporteve, në Sektorin e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve, pranë Bashkisë Mallakastër;

vendimin e KMSHC-së, të cilët janë të përmendur më sipër. Përsa i përket punonjësve të tjerë të përmendur në këtë vendim, në shkresë sqarohet se, nga ana e këtij institucioni do të merren masat e nevojshme për shpalljen e pozicioneve si të lira dhe zhvillimin e procedurave ligjore, sapo të hapet procesi i shpalljeve, që është pezulluar për shkak të situatës se krijuar nga pandemia globale Covid-19. Faktet e sipërpërmendura rezultojnë edhe në shkresën nr. 477/1, datë 14.02.2020, drejtuar Prefektit të Qarkut Fier. Njëkohësisht, referuar e-mailit e datës 13.01.2020 të dërguar nga Bashkia Mallakastër, në adresë të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, përkatësisht inspektorit S.LL., të Sektorit të Koordinimit me Qeverisjen Vendore rezultojnë se është dhënë i njëjti informacion. Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se përveç ankuesit, në kuadër të zbatimit të vendimit të KMSHC-së janë larguar nga puna edhe punonjës të tjerë të Bashkisë Mallakastër.

Për sa më sipër, në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD, Komisioneri gjykon se E.Z. nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Bashkisë Mallakastër.

- *Lidhur me momentin e dytë, që ka lidhje me pretendimin e ankuesit se autoritetet përgjegjëse të Bashkisë Mallakastër nuk i kanë dhënë kopje të Vendimit nr. 112, datë 05.11.2019, të KMSHC.*

Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Mallakastër e ka njoftuar z. E. Z., lidhur me përmbajtjen e Vendimit nr. 112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së, por nuk i kanë dhënë kopje të këtij vendimi edhe pse ankuesi e ka kërkuar në mënyrë të përsëritur verbalisht dhe zyrtarisht nëpërmjet shkresës së datës 02.03.2020. Për sa më sipër, rezultojnë se Bashkia Mallakastër nuk i ka kthyer përgjigje shkresës së z. E.Z.. Vlen të theksohet fakti se mosdhënia e një kopjeje të këtij vendimi pohohet edhe në shkresën nr. 1277, datë 12.06.2020, e Bashkisë Mallakastër, ku citohet shprehimisht: *“Për sa i përket pretendimit të ankuesit se nuk i është dhënë zyrtarisht një kopje e vendimit nr. 112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së, ju theksojmë se punonjësit i është komunikuar atakimi i emrit në vendim, sikurse edhe të gjithë punonjësve të tjerë, i është sqaruar përmbajtja e vendimit dhe se ky vendim është i publikuar në faqen zyrtare të KMSHC-së. Çdo individ mund të njihet me përmbajtjen e vendimit pa asnjë pengesë. Për këtë fakt pretendimi i ankuesit është absolutisht i pabazuar.”*

Referuar pikës 8, të Vendimit nr. 112, datë 05.11.2019, të KMSHC-së citohet: *“Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, Ministria*

e Brendshme, si dhe çdo punonjës, që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim”.

Në vijim, ankuesi i është drejtuar zyrtarisht KMSHC-së, për të disponuar një kopje të vendimit të sipërpërmendur. KMSHC i ka kthyer përgjigje ankuesit nëpërmjet shkresës nr. 200/1, datë 24.02.2020, ku citohet: *“Për më shumë informacion mund t’i referoheni faqes zyrtare të Komisionerit www.kmshc.al, ku do të gjeni të publikuara në Rubrikë “Publikime-Vendime” të gjitha vendimet e nxjerra nga Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.”*

Për sa më sipër, në bazë të nenit 3, të ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), Komisioneri çmon se ankuesi ka patur të drejtë të dispononte një kopje të vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, të cilin Bashkia Mallakastër ka patur detyrim ligjor për t’ia dhënë, pavarësisht njoftimit dhe shpjegimit të përmbajtjes nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër. Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se mosdhënia e aktit të sipërpërmendur, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me kalimin e afateve për zbatimin e së drejtës legjitime të z. E.Z., për ta ankimuar atë në gjykatë.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD, Komisioneri gjykon se mosdhënia e një kopjeje të vendimit të sipërcituar, pavarësisht se kjo është një praktikë, që është zbatuar edhe për punonjësit e tjerë nga ana e Bashkisë Mallakastër, konsiderohet e padrejtë dhe disfavorizuese kundrejt ankuesit E.Z..

- *Lidhur me momentin e tretë, ku ankuesi pretendon se nuk është sistemuar në një pozicion tjetër, pune brenda Bashkisë Mallakastër.*

Në vijim të Vendimit nr. 112/2019, të KMSHC-së, Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka ngritur grupin e ristrukturimit, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 535, datë 31.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, *“Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”*. Referuar pikës 1, të këtij Urdhëri Komisioni i Ristrukturimit ka patur si detyrë transferimin, sistemimin dhe lirimimin e nëpunësve civil të konfirmuar. Sipas Urdhërit të sipërcituar, Komisioni do të shqyrtonte mundësitë e sistemimit të çdo punonjësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe të propozojë transferimin e nëpunësit në një pozicion, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Në rast se, nëpunësi nuk do të plotësojë kërkesat specifike, apo nuk ekziston mundësia e sistemimit, nëpunësi civil do të lirohej nga detyra.

Sistemimi brenda institucionit do të kryhej për ata punonjës që gëzonin ende statusin e nëpunësit civil. Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Mallakastër, në zbatim të nenit 64, pika 4 ligjit nr.

152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), vlefshmëria e statusit të nëpunësit civil për z. E.Z. ka qenë në fuqi deri në datën 31.01.2020¹⁰. Në nenin 64, pika 4, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht: *“Nëpunësit civil të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë të konkurojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”*.

Në shkresën nr. 1277, datë 12.06.2020, Bashkia Mallakastër ka sqaruar se ankuesit E.Z. i është propozuar që në procesverbalin e takimit të datës 27.01.2020, të shkruante e të kërkonte për t’u emëruar si specialist në po të njëjtin sektor, brenda periudhës që ai gëzonte statusin e nëpunësit civil, por ai nuk ka pranuar me pretendimin se kishte ulje page dhe nuk mund të kalonte nga përgjegjës sektori në specialist. Për sa më sipër, rezulton se propozimi përkatës për E.Z. nga struktura përkatëse e Bashkisë Mallakastër është bërë verbalisht, pasi ky institucion nuk ka dërguar në cilësi prove asnjë akt, nëpërmjet së cilit të rezultojë se ankuesit i është bërë një propozim konkret për t’u sistemuar në pozicionin e specialistit pranë të njëjtit sektor, i cili mbështetur në sa më sipër rezulton të ketë qenë pozicion vakant dhe i disponueshëm për të sistemuar E. Z.. Bashkia Mallakastër thekson faktin se E.Z. nuk ka depozituar asnjëherë kërkesë me shkrim nëpërmjet së cilës të ketë kërkuar për t’u sistemuar në një pozicion tjetër, më të ulët hierarkisht, brenda Bashkisë Mallakastër. Mbështetur në pikën 3, të Urdhërit të Brendshëm nr. 535, datë 31.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, *“Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”* citohet shprehimisht: *“Komisioni do të shqyrtojë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike...”*. Në këtë Urdhër përcaktohet shprehimisht detyrimi i institucionit për të kryer propozim për transferim të mundshëm të personit në një vend të lirë. Për rastin e E.Z. nuk ekziston asnjë propozim me shkrim nga ana e strukturës përkatëse të Bashkisë Mallakastër, për t’u transferuar në pozicionin e specialistit të mjedisit pranë së njëjtit sektor. Në Urdhërin e mëposhtëm nuk ekziston asnjë parashikim, në bazë të së cilit kalimi i punonjësit në një vend të lirë, kushtëzohet nga depozitimi i një kërkesë specifike me shkrim apo kërkesë të shënuar në procesverbalin e takimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

¹⁰ Në zbatim të nenit 64, pika 4 ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar);

Njëkohësisht, Komisioneri ka konstatuar se fillimi i procedurës për largimin nga puna për ankuesin ka filluar në datë në 23.01.2020¹¹, moment ky, kur ankuesi gëzonte ende statusin e nëpunësit civil, pasi vetëm në datën 31.01.2020, vlefshmëria e këtij statusi për ankuesin do të përfundonte.

Ndërkohë që, rezultojnë se ka punonjës të tjerë, të përfshirë në Vendimin nr. 112/2019 të KMSHC-së të cilët rezultojnë të sistemuar në pozicione të tjera pune, i tillë si rasti i R.L., ish-Përgjegjës i Sektorit të Financës në Drejtorinë Ekonomike, për të cilin në referencë të shkresës nr. 1080/1, datë 27.05.2020, të Bashkisë Mallakastër drejtuar Komisionerit për Mbikqytjen në Shërbimit Civil, rezultojnë se Bashkia Mallakastër është shprehur se për këtë punonjës po merret në konsideratë mundësia për t'u sistemuar në një pozicion hierarkisht me të ulët.

Përveç momentit të mësipërm, Komisioneri ka konstatuar se nga 11 punonjës, të cilët rezultojnë se janë përfshirë në Vendimin nr. 112/2019, të KMSHC-së, procedurat për largim nga puna janë ndjekur vetëm për 4 prej tyre, 1 punonjës tjetër, përkatësisht z. R. L. është sistemuar në një pozicion hierarkisht me të ulët, ndërsa pjesa tjetër e punonjësve rezultojnë se nuk janë larguar nga detyra, por kanë vazhduar të qëndrojnë në pozicionet e tyre të punës dhe kanë konkuruar në pozicionet e shpallura vakante në muajin korrik 2020, nga Bashkia Mallakastër. Në shkresën zyrtare të Bashkisë Mallakastër, në asnjë rast nuk është përmendur fakti se ndaj 6 (gjashtë) punonjësve të tjerë të përfshirë në vendimin e sipërpërmendur të KMSHC-s, do të zbatohen procedurat për largimin nga puna, por thjesht është sqaruar se procedurat për shpalljen e pozicioneve vakante, janë pezulluar përkohësisht si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Për sa më sipër, në datën 24.07.2020, Bashkia Mallakastër ka shpallur 17 pozicione pune të lira, për procedurën e pranimit nga jashtë sistemit të shërbimit civil. Njëri prej këtyre pozicioneve të lira është edhe pozicioni “specialist mjedisi”, pranë Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër. Për sa më sipër, mbështetur dhe në shkresën nr. 1665/1, datë 19.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, me lëndë “*Njoftim i listës përfundimtare të rezultatit për verifikimet paraprake për procedurën e pranimit nga jashtë sistemit të shërbimit civil për nëpunësit civilë*”, si dhe shkresën nr. 1665/2, datë 14.09.2020, e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me lëndë “*Njoftim i listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve për procedurën e pranimit nga jashtë sistemit të shërbimit civil për nëpunësit civilë*”, rezultojnë se 5 punonjës që rezultojnë të përfshirë në Vendimin

¹¹ Njëpërmjet shkresës nr. 263, datë 23.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, me lëndë “*Njoftim për zhvillimin e takimit për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës*”,

nr. 112/2019, të KMSHC-së, kanë konkuruar dhe kanë rezultuar fitues në këto pozicione pune, përkatësisht z. N.A., z. A.SH., znj. M.Sh., z. Xh.S., z. A. A. Në pozicionin “specialist mjedisi”, pranë Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit ka rezultuar fituese znj. V.M. Nga kontaktimi i patur me ankuesin rezulton se ai nuk ka konkuruar për këtë pozicion pune, apo për ndonjë pozicion tjetër pune të shpallur nga Bashkia Mallakastër. Një nga fituesit e mësipërm rezulton të jetë edhe z. A.A., i cili u largua nga puna njëkohësisht me ankuesin E. Z., pasi akti i emërimit të tij ishte konsideruar i paligjshëm nga ana e KMSHC-së. Aktualisht, z. A.A. rezulton fitues në pozicionin e punës specialist i Sporteve, në Sektorin e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve, pranë Bashkisë Mallakastër.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se:

1. Ekzistonte detyrimi i Bashkisë Mallakastër për të sistemuar E.Z. në pozicionin e specialistit pranë së njëjtit sektor, në kushtet kur për periudhën në fjalë pozicioni ka qenë vakant, si dhe këtë praktikë e ka kryer në rastin e R.L., ish-Përgjegjës i Sektorit të Financës në Drejtorinë Ekonomike, i cili në referencë të shkresës nr. 1080/1, datë 27.05.2020, të Bashkisë Mallakastër drejtuar Komisionerit për Mbikqyrjen në Shërbimit Civil, rezulton se Bashkia Mallakastër është shprehur se për këtë punonjës po merret në konsideratë mundësia për t’u sistemuar në një pozicion hierarkisht me të ulët.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Mallakastër.

2. Punonjësit, aktet e emërimit të së cilëve janë cilësuar si të paligjshme nga ana e KMSHC-së, janë trajtuar me 2 standarde. Ndaj ankuesit dhe tre ish- punonjësve¹² të tjerë është zbatuar procedura e largimit nga puna, ndërkohë që një pjesa tjetër e tyre ka vazhduar të punojë në pozicionet respektive të punës, deri në momentin e shpalljes së pozicioneve të tyre/të tjera të punës vakant, ku kanë konkuruar duke qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mallakastër, si dhe kanë rezultuar fitues në pozicionet e punës që kanë mbajtur më parë ose në pozicione të tjera.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Mallakastër.

¹² Dy prej këtyre punonjësve nuk e gëzonin statusin e nëpunësit civil në momentin e largimit nga puna, ndërsa njëri prej tyre e gëzonte ende këtë status, sikurse ankuesi

B. Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.

E. Z. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”¹³, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë. Referuar Vërtetimit nr. 1, datë 02.02.2020, të lëshuar nga PD, Dega Mallakastër rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i këtij subjekti politik.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se E.Z. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Mallakastër, pasi nuk i është dhënë në administrim një kopje e Vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, akt ky nëpërmjet së cilit ankuesi prekej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi Urdhëri i emërimit të tij në pozicionin “*Përgjegjësit të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit*”, pranë Bashkisë Mallakastër ishte gjetur i paligjshëm, si dhe ankuesit i është mohuar e drejta e ankimit.

Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues, pasi nuk është sistemuar në pozicionin vakant të specialistit të mjedisit

¹³ Referuar vërtetimit nr. 1, datë 02.02.2020, të lëshuar nga PD, Dega Mallakastër rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i këtij subjekti politik.

pranë së njëjtit sektor, përgjatë periudhës kohore, kur ai e gëzonte ende statusin e nëpunësit civil. Njëkohësisht, KMD ka gjykuar se zbatimi me dy standarde i Vendimit nr. 112/2019, të KMSHC-së ndaj punonjësve të përfshirë në të, provon gjithashtu qendrim të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë ndaj ankuesit.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individit të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë¹⁴, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili*

¹⁴ Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;

lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit” (paragrafi 55).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në nenin 12, pika 1, gërma (c), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative¹⁵, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Mallakastër, e cila duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

¹⁵ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

¹⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njëherën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁷

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm të ankuesit nga ana e Bashkisë Mallakastër, pasi (1) atij nuk i është dhënë në administrim një kopje e Vendimit nr. 112/2020, të KMSHC-së, edhe pse ky akt e prekte në mënyrë të drejtpërdrejtë ankuesin, (2) Bashkia Mallakastër nuk ka kryer një propozim konkret dhe nuk e ka sistemuar E.Z. edhe pse ka patur mundësinë, në pozicionin e mëparshëm të punës si specialist mjedisi pranë të njëjtit sektor, në kushtet kur ky pozicion ka qenë vakant në periudhën në fjalë, si dhe (3) është konstatuar zbatimi me dy standarde i Vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, për 11 punonjësit e përfshirë në të.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përkatësisht në referencë të Vërtetimit nr.1, datë 02.02.2020, të lëshuar nga PD, Dega Mallakastër rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i këtij subjekti politik. Referuar aktit të sipërcituar, E. Z. ka marrë pjesë si anëtar (numërues) i Grupit të Numërimit të Votave (GNV-ve) pranë KZAZ-së nr. 63, Qarku Fier, Bashkia Mallakastër në zgjedhjet vendore 2015, si përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Ai ka marrë pjesë si anëtar i Komisionit në QV-në 3150 (Lapulec), KZAZ nr. 63, Qarku Fier, Bashkia Mallakastër, si dhe anëtar (numërues) i Grupit të Numërimit të Votave (GNV-ve) pranë KZAZ nr. 63, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë (2017), si përfaqësues i Partisë Demokratike.

Për sa më sipër, Komisioneri ka krijuar bindjen se si pasojë e ekspozimit të ankuesit si një eksponent aktiv në subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë, si dhe në kushtet kur Bashkia Mallakastër është njësi e qeverisjes vendore me një numër të vogël popullsie¹⁸, ku njerëzit njihen mirë me njëri tjetrin, ky institucion ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në rastin konkret, Komisioneri ka konstatuar trajtim të padrejtë të ankuesit nga ana e Bashkisë Mallakastër në 3 momente:

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁸ Bashkia Mallakastër ka sipërfaqe 329.19 km katrorë dhe një popullsi prej 43.033 banorësh;

Momenti i parë konsiston në faktin se ky institucion nuk i ka dhënë ankuesit kopje të vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, pavarësisht se kishte detyrim ligjor për të kryer një gjë të tillë. Për sa më sipër, Bashkia Mallakastër ka sqaruar se ankuesi është njohur me përmbajtjen e Vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, si dhe përcaktimet e tij dhe një praktikë e tillë është zbatuar për të gjithë punonjësit e afektuar në këtë vendim. Në këtë kontekst, një praktikë e tillë edhe pse jo korrekte është zbatuar ndaj të 11 individëve të përfshirë në Vendimin e KMSHC-së. Në këto kushte, Bashkia Mallakastër ka provuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike dhe trajtimit të padrejtë e disfavorshëm nga ana e këtij institucioni.

Momenti i dytë konsiston në faktin se Bashkia Mallakastër nuk ka kryer një propozim konkret dhe nuk e ka sistemuar E.Z. edhe pse ka patur mundësinë, në pozicionin e mëparshëm të punës si specialist mjedisi pranë të njëjtit sektor, në kushtet kur ky pozicion ka qenë vakant në periudhën në fjalë. Një procedurë të tillë, Bashkia Mallakastër e ka zbatuar në një rast tjetër analog me ankuesin. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Bashkia Mallakastër ka dështuar për të provuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm, apo të pabarabartë të ankuesit, si dhe nuk ka demonstruar se megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv. **Në këto kushte, Komisioneri gjykon se ankuesi është diskriminuar, për shkak të bindjes së tij politike, nga ana e Bashkisë Mallakastër.**

Momenti i tretë konsiston në faktin se Komisioneri ka konstatuar zbatimin e Vendimit nr. 112/2019 të KMSHC-së, me dy standarde për 11 punonjësit e përfshirë në të. Katër punonjës janë larguar nga puna, një punonjës është sistemuar në një pozicion hierarkisht më të ulët, ndërkohë që pjesa tjetër e punonjësve kanë vazhduar të punojnë në pozicionet e tyre, të punës, ndërkohë që janë kryer shpalljet për konkurim me procedurë nga jashtë shërbimit civil. Ata kanë konkuruar dhe kanë rezultuar fitues në pozicionet e tyre të punës ose në pozicione të tjera punë të shpallura nga Bashkia Mallakastër.

Për sa më sipër, Bashkia Mallakastër e ka informuar Komisionerin se përveç E. Z., janë larguar edhe 4 punonjës të tjerë, të cilët prekeshin nga vendimi i sipërcituar i KMSHC. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se bindja politike e tre punonjësve të tjerë, të cilët janë larguar nga puna, sikurse ankuesi, mund të ketë qenë e ndryshme, apo edhe e njëjtë nga ajo e

E. Z. Në mungesë të një informacioni të tillë, Komisioneri nuk mund të shprehet, nëse veprimi i padrejtë i Bashkisë Mallakastër, ndaj ankuesit ka lidhje me shkakun e bindjes së tij, politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1, nenin 7, pika 1, neneve 13 e 15, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të E. Z., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Mallakastër.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak – bindja politike
Fusha – Punësim
Lloji i vendimit - Diskriminim